



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

V E N D I M
Nr. 369, Datë 16.11.2021

**PËR MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT
PËR PROKUROREN ENKELEDA MILLONAI**

Në mbështetje të nenit 149/ç, të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, të nenit 9, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të germës “a”, të pikës 1, të nenit 189, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 8, të Rregullores së Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, miratuar me Vendimin nr.64 datë 15.04.2019, pasi u njoh me kërkesën me nr. Prot 2288, datë 21.10.2021 dhe Relacionin e përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokuroren Enkeleda Millonai, si eksperte pranë Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, në kuadër të projektit “Mbështetje në forcimin e sundimit të ligjit në Shqipëri dhe hartimit të disa udhëzimeve praktike për teknikat e intervistimit të viktimave të dhunës seksuale”, për periudhën tetor-dhjetor 2021, në total 5 ditë pune jashtë orarit zyrtar.
2. Të njoftohen për këtë vendim znj. Enkeleda Millonai dhe Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



**KRYETAR
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA**

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
ELOIDA GOXHI

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
MOISI DUDA

ANËTAR
TARTAR BAZAJ